

Syllabusi i lëndës

Lënda: Histori e religjioneve

Programi i studimit: Teologji Islame

Numri i ECTS kredive: 5

Statusi i lëndës: Obligative

Kodi i lëndës: 404

Fondi i orëve: 2+1

Viti akademik: 2024/2025

Semestri: VII

Mësimdhënësi: Prof. dr. Fahrush Rexhepi

Përshkrimi i shkurtë i lëndës

Dizajnimi i lëndës Histori e religjionit si shkencë bashkëkohore dhe e rëndësishme ofron njohuri për bashkëpunimin e ndërsjellë në mes religjioneve dhe besimeve të ndryshme të botës bashkëkohore për të avansuar edhe më tej kulturën dhe civilizimin njerëzor. Lidhur me këtë shkencë avokati amerikan Thomas Clark, në vitin 1963, para gjyqit kishte deklaruar se : “mund të thuhet lirisht se edukimi i ndokujt nuk do të jetë i plotë pa studiuar krahasimin e religjioneve apo historinë e religjioneve”. Prandaj, disa dijetarë bashkëkohorë me të drejtë historinë e feve e përkufizojnë si histori krahasimtare të feve, meqë ajo nuk është thjeshtë vetëm një studim historik, por në të njëjtën kohë është edhe studim krahasues. Duke pasur parasysh se religjioni ka bashkëjetuar me ne përgjatë historisë, duke iu përgjigjur pyetjeve më të ndërlikuara që qenia njerëzore mund të ketë parashtruar, atëherë pa mëdyshje mund të themi se sa herë që kthehemi dhe kërkojmë ndërgjegjen njerëzore shohim se ajo është e ndërlidhur ngusht me religjionin.

Qëllimet dhe rezultatet e pritura të nxënies:

1. Njohuri për vendosjen e bazave të historisë së religjionit nga shkenctarët musliman dhe ata perëndimor gjatë shek. 19.
2. Njohuri mbi konceptet më të përhapura të religjionit siç janë: monoteizmi, panteizmi, dualizmi, politeizmi, ateizmi etj.

3. Zhvillimi i njohurive për religjionet e popujve të lashtë, Egjipti, Persia e lashtë, India etj.
4. Përvetsimi i njohurive për fetë parahistorike në Azinë e mesme-fetë e Mesopotamisë së vjetër.
5. Përvetsimi i njohurive për religjionet në Anadollin e Vjetër.
6. Njohuri mbi religjionet e vjetra në Arabi – Arabia veriore, jugore dhe e mesme.
7. Zhvillimi i njohurive për religjionet e vjetra të Evropës – Grekët, Romakët, Teutonët, Keltët, Amerikanët etj.

Metodologjia e mësimdhënies:

Mësimi do të zhvillohet në formë të ligjeratave, stimulimit të studentëve në diskutime interaktive etj...

Përmbajtja e lëndës:

Java e parë: Rëndësia e religjionit- nevoja e besimit në religjion.

Java e dytë: Kontributi i shkenctarve musliman dhe perëndimor në studimin e religjionit.

Java e tretë: Fetë parahistorike në Azinë e Mesme.

Java e katërt: Religjioni i Mesopotamisë së vjetër- religjioni Sumer, Babilonas, asirian.

Java e pestë: Religjioni në Egjiptin e vjetër- Koncepti për gjithsinë- Hyjnitë dhe fuqitë mbinatyrore.

Java e gjashtë: Religjionet e vjetra në Arabinë veriore, konceptet për Zotin- paraqitja e monoteizmit.

Java e shtatë: Religjioni në Arabinë jugore dhe në Arabinë e mesme, kultet- Ismaili a.s.

Java e tetë: Koncepti për Zotin dhe besimet e arabëve.

Java e nëntë: Religjionet e popujve analfabet, Animizmi.

Java e dhjetë: Zoroartrianizmi (zjarrputizmi)- Historiku

Java e njëmbëdhjetë: Budizmi- adhurimet në budizëm.

Java e dymbëdhjetë: Fetë në Kinë-Taoizmi, Konfuqizmi.

Java e trembëdhjetë: Religjioni dhe besimet e grkëve të vjetër.

Java e katërbëdhjetë: Besimet e vjetra të romakve

Java e pesëmbëdhjetë: Feja dhe besimet e vjetra Teuzone (fis i vjetër gjerman).

Kriteriumi dhe komponentët e vlerësimit:

Pjesëmarrje dhe angazhimi në ligjeratë 10%

Punimi seminarik 10%

Kollekfiumi i parë 40%

Kollekfiumi i dytë 40%

Total 100%

Literatura obliguese:

1. Ekrem Sarëkqëollgu, Historia e feve, Logos-A, Shkup, 2010.
2. Material i përgatitur nga profesori i lëndës.

Literartura konsultative:

1. Dr. Zija Abdullahu, Studim krahasimtar i feve, Prishtinë 2010.
2. Kevin M. Schutzz and Paul Harvey, Everywhere and Nowhere: Recent Trends in American Religious History and Historiography, Journal of the American of Religion, 78, (march, 2010).